



<b>KRU "GJAKOVA" SHA. Gjakovë</b>			
Marrë në datën: 29.11.2019			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	484		

Bazuar në nenin 34 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, me qëllim të harmonizimit të shprehjeve të caktuara, të përdorura në aktet nënligjore të Kompanisë Rajonale "Gjakova", Bordi i Drejtorëve të KRU "Gjakova" nxjerrë:

**RREGULLORE NR. 06/2019 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E, RREGULLORES NR. 01/2017, RREGULLORES NR. 03/2017, RREGULLORES NR. 04/2017 DHE RREGULLORES NR. 05/2017**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim harmonizimin e shprehjeve të caktuara, të përdorura në aktet nënligjore të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit dhe ofruesve të shërbimeve të ujit.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet për aktet nënligjore në vijim:
  - 1.1. Rregulloren nr. 01/2017 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve;
  - 1.2. Rregulloren Nr. 03/2017 për Procedurat e Ndërprerjes së Shërbimeve të Ujit;
  - 1.3. Rregullore Nr. 04/2017 për Procedurat e Faturimit të Shërbimeve të Ujit;
  - 1.4. Rregullore Nr. 05/2017 për Matjen e Konsumit të Ujit.

**Neni 3**  
**Ndryshim plotësimi i akteve nënligjore të Kompanisë Rajonale "Gjakova"**

1. Shprehjet e përdorura në aktet nënligjore të cekura në Nenin 2 të kësaj Rregullore, riformulohen me tekstin si në vijim:
  - 1.1. **Zona e shërbimit** - zona e shërbimit e cila është përcaktuar me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës;
  - 1.2. **Ofrues i shërbimeve** - çdo person juridik i regjistruar që ka aktivitet primar, ofrimin e shërbimeve të ujit;

paguar detyrimet për shërbimet e ofruara;

- 1.4. Secilën herë që përmendet në aktet nënligjore të Kompanisë Rajonale “Gjakova” Sh.A. “Komisioni Këshillues i Konsumatorëve”, zëvendësohet me tekstin si në vijim: “Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve” i cili është themeluar dhe vepron në kuadër të Autoritetit;
- 1.5. Ujëmatës - çdo aparat apo pajisje i cili përdoret nga ofruesi i shërbimeve për të matur sasinë e ujit të përpunuar dhe konsumuar.

#### **Neni 4 Dispozitat kalimtare**

Me këtë Rregullore bëhet ndryshim plotësimin i rregulloreve përkatëse, për të harmonizuar shprehjet e përdorura në këtë Rregullore.

#### **Neni 5 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi shatë (7) ditë pas aprovimit nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të KRU “Gjakova”.

Datë 29/11 2019  
Gjakovë

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve  
K.R.U.  
“GJAKOVA”  
SH.A.  
GJAKOVË  
Fatos Koshi

